

VENDIM
Nr. 82, datë 11.2.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.226, DATË 9.4.1996 “PËR SHKËMBIMIN PËR EFEKT KOMPENSIMI TË TRUALLIT DHE TË VILËS NR.6, PRONË E SHTETIT SHQIPTAR ME TRUALLIN DHE VILËN NR.30, PRONË E MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE”

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 9.4.1996 “Për shkëmbimin për efekt kompensimi të truallit dhe të vilës nr.6, pronë e shtetit shqiptar me truallin dhe vilën nr.30, pronë e Mbretërisë së Britanisë së Madhe”, ndryshohet si vijon:

“Të bëhet shkëmbimi për efekt kompensimi i vilës aktuale nr.6, që rrethohet nga një oborr prej 1640 m², pronë e shtetit shqiptar me vilën nr.30 e rrethuar nga një oborr me sipërfaqe prej 4307,54 m², pronë e shtetit britanik. Në këtë mënyrë përfaqësia britanike kalon nga vila nr.30 me oborrin përreth në vilën nr.6 me oborrin përreth”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi